REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVË-
PRANUAR NË:
ACCEPTED ON: 24/09/2026
PRIMLJENO:
02/261

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Nr. 02/_____
Datë:15.09.2026

Procesverbal
i mbledhjes së -III (tretë) të jashtëzakonshme e Komitetit për Politikë dhe Financa

Koha:15.09.2026 ora 10:30
Vendi:Salla e mbajtjes së takimeve të Komisioneve të Kuvendit Komunal të Malishevës
Të pranishëm:Kryesuesi i Kuvendit z.Fatmir Ademaj
Anëtarët e Komisionit për Politikë dhe Financa:Halil Morina,Edonë Hoti,Gentiana Mehemti,Imran Xhyliqi,Xheneta Morina,Veton Zogaj.
Drejtor për ekonomi dhe financa:z.Blerim Thaçi.
Zyrtar ligjor z.Muharrem Morina.
Përfaqësues nga zyra e informimit z.Artan Paçarizi.

Mbledhjen e udhëheqi dhe e kryesoi Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj meqenëse konstatoi se korumi ishte i mjaftueshëm për mbajtjen e seancës e vuri në votim rendin e ditës si në vijimë:

Rendi i ditës

1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e -III- (tretë) urgjente e mbajtur me datë:13.07.2026.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e -IV-(katër) urgjente e mbajtur me datë:22.07.2026.
2. Shqyrtimi i shkresës së Projekt Buxhetit për vitin 2027-2029.
3. Shqyrtimi dhe trajtimi i kërkesave të pranuara në zyrën e Kryetarit.
4. Shqyrtimi dhe trajtimi i kërkesave të pranuara në zyrën e Kryesuesit.

Rendi i ditës u miratua unanimishtë nga të gjithë anëtarët e KPF-së.
Rezultati i votimit:7 për, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 1

Pika e parë e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e -III- (tretë) urgjente e mbajtur me datë:13.07.2026.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e -IV-(katër) urgjente e mbajtur me datë:22.07.2026.

Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj e vuri në votim pikën e parë të rendit të ditës dhe u miratuan me vota unanime.
Rezultati i votimit:7 për,0 kundër,0 abstenime.

Pika 2

Pika e dytë e rendit të ditës: Shqyrtimi i shkresës së Projekt Buxhetit për vitin 2027-2029.
Kryesues i KPF-së z.Fatmir Ademaj:Për këtë pikë të rendit të ditës fjalën ja kalojë z.Blerim Thaçit drejtorit për ekonomi dhe financa.

Blerim Thaçi(drejtor për ekonomi dhe financa):Përshëndetje për të gjithë!Për vitin 2027 buxheti total është 23,161,855.00€ te kategoria e pagave është 13,495,393.00€,te komunalit 550,000.00€,te subvencionet është 600,000.00€ dhe për projekte kapitale janë planifikuar 15,616,463.00€.Nëse e analizojmë tabelën në vija të trasha sipas kategorive mbi 60% është e projektuar te kategoria e pagave.Ky nuk është një buxhet i cili do të na mundësoj realizimin e kërkesave të cilat janë paraqitur nga qytetarët dhe nga institucionet.Me vetë faktin e zvogëlimit të numrit të banorëve dhe obligimet e krijuara nga vitet paraprake do me thënë është shtrënguar te kategoria e mallrave dhe shërbimeve të cilat i kemi pasur afërisht rreth 2.5 milion i kemi shtuar 2.9 milion shkaku i obligimeve që i kemi te lëndët përmbarimore që janë shkaktuar dëme te katër kategoritë duke i përjashtuar pagat.Unë nuk do të ju marrë kohë te prezantimi i buxhetit pres nga ju diskutim dhe kërkesat të cilat i keni me i ngritur.
Kryesues i KPF-së z.Fatmir Ademaj:Faleminderit drejtor për prezantimin.Hapi debatin për këtë pikë të rendit të ditës.

Veton Zogaj(anëtar i KPF-së):Përshëndetje për të gjithë!Drejtor unë e kam pranuar materialin për buxhet,unë dëshiroj me i ndarë disa detaje këtu,te shtylla e arsmit,te stafi është 1028 mësimëdhënës staf profesional në shkolla.Dëshiroj me ditur në këtë pjesë a është përfshirë edhe pjesa e DKA-së për rritjen që e kemi bërë,prej 17 edukatorëve dhe stafin tjetër ndihmës për çerdhet publike,të cilën e kemi miratuar në buxhet?Sa i përket investimeve kapitale jam duke e vërejtur në këtë buxhet që janë përsëritura prapë,në vitin e kaluar nëse nuk gabojë kanë qenë të planifikuar afërishtë 100,000.00€ a kanë filluar punimet?Kurse për vitin 2027-të janë parashikuar rreth 556,000.00€,a është bartuar ajo shkuam e vitit të kaluar?Te investimet kapitale janë cekur vetëm fshatrat kurse emërtimi i rrugëve nuk është cekur.A bëhet fjalë për lagje apo për rrugët lokale që i lidhin me komunën e Malishevës?Sa i përket shpenzimeve përshembull te zyra e Kryetarit që janë parashikuar rreth 200,000.00€,këtu dëshiroj me pyetur më shumë Kryesuesin tek shuma prej 297,000.00€ a janë parashikuar për pagat e stafit të asambleistët të Kuvendit Komunal apo këtu është parashikuar edhe për ndonjë investim kapital në kuadër të sallës së Kuvendit Komual për renovimin e sallës të cilën e kemi kërkuar në vitin e kaluar?Te administrata komunale dhe personeli 1,600.000.00€,qështjet gjinore 21,000.00€ unë nuk e di se qfarë është parashikuar konkretisht!Te infrastruktura rrugore i keni parashikuar afërsisht 2,070.000.00€,unë e kam parë që është shpallur një tender prej 5.4 milion euro në komunën e Malishevës,mjetet e janë të vitit 2026-të?Unë më tepër e kam dilemën te drejtoria e arsimit, sepse ne kemi kërkuar që me shtyer përpara këtë stafin ndihmës.A është i paraparë numri i punëtorëve në këtë buxhet?Faleminderit shumë.

Halil Morina(anëtarë i KPF-së):Përshëndetje për të gjithë!Ky projekt buxhet të cilën e kemi ne këtu në vija të trasha i plotësonë kriteret e një dokumenti të tillë edhe pse nganjëherë është vështirë i lexueshëm për shkak që disa fjalë nuk janë të përfunduara,disa nuk vërehen për shkak që nuk i ka vendosur mirë sistemi të cilat nuk kanë pasur mundësi me u inkorporuar ashtu siq

duhet.Shqetësimi ynë kryesor është që sa herë që e kemi buxhetin është për shkak të mundësive tona të vogla financiare që ne i kemi krahas kërkesave dhe nevojave të mëdhaja që janë në komunën tonë.Më e keqja është që vitin e kaluar buxhetin të cilin e kemi miratuar shumica e atyre projekteve që i kemi votuar nuk janë realizuar.E arsyeja kryesore që ato nuk janë realizuar është për shkak të mjeteve financiare që nuk i kemi.Të gjithë ne jemi dëshmitarë duke e parë se qfarë është duke ndodhur me procedurat përmbarimore,ky është një shqetësim i madh por shpresoj që institucionet e nivelit qëndror kanë me pasur parasysh këtë punë në mënyrë që komunat mos me i sjellur para një kolapsi total.Te tabela 4.2 te planifikimi mjedisor dhe inspeksioni në ekzekutim(në vazhdim) i kemi asfalltimin e disa rrugëve nëpër fshatra që e ka vlerën prej 18,000.00€.Qfarë nënkuptonë a është borxhi i cili ka mbetur i atyre rrugëve sepse kjo shumë është e pa mjaftueshme?Qfarë është duke u bërë me asfalltimin e rrugëve në Ngucat,Kravasari,Llapqevë dhe Mirushë,a janë të inkorporuara te faqja 4.3?A ka më tepër akse dhe nuk ju ka zënë hapsira?Te pjesa e parë për vitin 2027-të i kemi 100,000.00€ që janë parashikuar kurse te pjesa tjetër janë parashikuar 2,000,0000,00€ pse është bërë kjo ndarje?Ajo të cilën e kam vërejtur në këtë tabelë është që disa fshatra të komunës së Malishevës nuk i keni cekur te asfaltimi i rrugëve,nuk dëshiroj me u bërë lokalistë por nuk i keni cekur fshatin Aztrazub,disa fshatra i keni cekur nga dy e tri herë,mbi cilat kritere janë vendosur këto?Pse janë menjanuar disa fshatra të tjera?Pse në dokument duhet me figuruar disa fshatra e disa jo?Këto ishin disa pyetje që i kam për fillim kurse të tjerat do ti parashtrojë gjatë debatit.Faleminderit.

Blerim Thaçi(drejtor për ekonomi dhe financa):Së pari po filloj me ju tregu që ka të drejtë Halili sepse ka gabime teknike,pas kësaj mbledhje unë do të mundohem me rregulluar në mënyrë që me qenë më të kjarta emërtime sepse MAPL-ja nuk na lejonë të gjitha me i shkruar sepse e kanë me shkronja kurse për juve lejohet sepse është në Asamble,ne pasi e rregullojmë e dorëzojmë te zyra e sekretarisë.Te qështja e stafit të arsimit Veton,ne sipas informacioneve zyrtare para se me pregaditur Kab 2 e kemi pasur takimin me dapartamentin e buxhetit në Pejë,kërkesa e drejtorisë komunale të arsimit ka shkuar në Ministri të Arsimit,mirëpo problemi ka qenë që kur është themeluar komisioni për hartimin e projekt buxhetit,asnjë zyrtar përfaqësues i Ministrisë së Arsimit nuk ka qenë prezent kur është themeluar komisioni për hartimin e projekt buxhetit në nivel qëndror dhe ata nuk kanë pasur mundësi me marrë informacion prej kërkesave që i kanë paraqitur komunat,por duke pasur parasysh kërkesat paraprake aktualisht sipas gjendjes të cilën e kemi ne vetëm 7 pozita janë rritur në stafin parafillor çerdhe edukatore.Kërkesa juaj është bashkangjitur në Ministri dhe presim që ajo me kaluar në Parlament,pastaj është vota e tyre e cila do të na kishte ndihmuar.Te projektet kapitale janë investimet të cilat ne i kemi pasur problem me lëndët përmbarimore ky është shkaku që ne jeni vonuar me filluar me projektet e reja,këtë vit mbi një milion e gjysmë na i kanë marrë,fatëbardhësishtë është që ne i kemi zvogëluar obligimet sepse viti 2026-të ka buxheti ka qenë kryesisht me pjesën më të madhe të obligimeve që i kemi pasur,kurse tani kemi mbetur me shumë pak obligime dhe me projekte që kanë pasur me filluar këtë vitë.Do të ndalem te koletori që e përmende Veton ai ka qenë i paraparë edhe për vitin 2027-të që me përfunduar kjo kontratë me shumën prej 556,434,000.00€,këtu deshta me dhënë informacion para se me diskutuar Vetoni,deri tani janë kryer obligime 81,000.00€ te kjo kontratë që i bie,ne e kemi bërë planifikimin e këtij buxheti pa e ditur se qfarë është duke na ndodhur me buxhet nga po na marrin përmbaruesit sot aktualisht mundem me ju thënë se vetëm me të hyra vetanake jemi,mjetet në të gjitha kategoritë na janë marrë,te mallrat dhe shërbimet nuk kemi janë zero.Tani te gjdo e hyrë që krijohet ne mundemi me kryer pagesa që mundemi me i zvogëluar obligimet të cilat i kemi të kontraktuara.Rasti konkret të cilën e kemi te ekzekutimi i një faktuarë prej 81,000.00€ aty te kolektori zvogëlohet ndodhë që nëse ekzekutohet në Kuvend e sjelli me ndryshim sepse 81,000.00€ na mbesin pa i shpenzuar vitin e ardhshëm e kur te sjelli me ndryshim kërkoj aprovimin e juaj sepse ende nuk e di se sa muj me shpenzuar deri në fund të vitit sepse

edhe 600,50,00€ i kemi si mundësi me i krijuar si të hyra dhe me i shpenzuar edhe kjo nvaret prej të hyrave.Te pjesa tjetër 38,000.00€ që e tha Halili edhe 18,000.00€ sipas planifikimit mbesin vetëm edhe këto mjete që me përfunduar kontrata.E kemi edhe një kontratë në përfundim është ndërtimi i rrugëve,kanalizimit efekale dhe atmosferike në lagjen "Mirdita"janë obligim edhe 156,000.00€ në këtë vit nuk kemi por i kemi planifikuar për vitin e ardhshëm.Regullimi i energjisë efiçiente për objekte e kemi gjdo vitë mbi bazën e marveshjeve që e ka bërë komuna me agjensionin e kemi obligim vjetor 150,000.00€ kjo është strikt,nuk e di a është 12 vjet apo sa mirëpo kjo duhet me qenë planifikim i vazhdueshëm.Te tabela janë cekur disa projkete të cilat janë pa kod kjo nënkupton për projkte të reja.Renovimin e rrugëve nëpër fshatra unë në dëgjime publike i kam cekur magjistralet komunale për shembull rruga te varrezat e dëshmorëve që shkonë në Llozicë,rruga Carallukë-Drenovc,Lumishtë-Llapqevë,Banjë-Kravasari këto janë disa rrugë kryesore që janë planifikuara si projekte të reja prej vitit 2027-2029 ndoshta shkonë edhe viti 2030-të.Sipas drejtorisë së urbanizmit na është thënë që do të realizohen 100% dhe do të shtrohet asfallt i ri.Projekt të ri e kemi shkruar renovimin e shkollave ju ndoshta mendoni që janë projekte të njejta sepse kur e lexoni shkruan renovimi i shkollave por nuk janë të njejta renovimi dhe mirëmbajtja e nyjeve sanitare sipas kërkesave të shkollave është projekt i ri të cilat i kemi planifikuara 20,000.00€ për vitin e ardhshëm 100,000.00 € për vitin 2028-të dhe 80,000.00€ për vitin 2029-të,ndërsa e keni edhe një shumë prej 84,000.00€ renovimi i shkollave kjo kontratë është aktive e cila përfundonë vitin e ardhshëm.Ne kemi fat që obligimet që na kanë mbetur jemi afër me i përmbyllur.Viti i ardhshëm është rregullimi i rrugëve,kanalizimeve është një vëllim i madh punëve i cili ka me qenë.Te qështja e investimeve kapitale dhe asambleja është planifikuar edhe renovimi i sallës,unë nuk e di pse z.Argjendi nuk ka filluar me procedura,mjetet janë do të ishte mirë me filluar me renovuar sepse ka mundësi që përmbaruesit me na marrë ato mjete sepse fatëbardhësishtë ende përmbaruesit nuk i kanë marrë ato mjete,për mos me mbetur subficit do të ishte mirë me filluar procedurën,nëse nuk mundet me u përfundur kjo tërsishtë këtë vitë mundet pjesërishtë këtë vitë kurse deri në muajin shkurt të vitit të ardhshëm munden me u kryer obligimet.Do të ishte mirë me filluar me procedurën.

Fatmir Ademaj(Kryesues i KPF-së):Në Asamble komunale kërkesa për renovimin e sallës është votuar është qështje drejtorisë së e administratës eventualisht e drejtorisë së urbanizmit ndoshta për këtë ka ngecur.Në këtë qështje ne nuk kemi mundësi me ndërhyrë.Drejtoria e urbanizmit e ka bërë një projket uroj që kjo shumë shpejtë të shpallë tender.

Blerim Thaçi(drejtor për ekonomi dhe financa):Unë i kam njoftuar të gjitha drejtoritë që keni të drejtë më së largu deri më 20 Tetor me i paraqitur kërkesat për investimet kapitale,neve na ka mbetur vetëm edhe një muaj,nëse fillonë një procedurë minimuni i ka 22 ditë një procedurë,kur mundet me u bërë inplementimi pastaj,pagesat e investimeve kapitale ne kemi mundësi me i bërë deri në muajin dhjetor.

Fatmir Ademaj(Kryesues i KPF-së):A ka dikush ende për debat?Nëse nuk ka e hedhim në votim.Kush është për?

Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa konstatoi se me vota unanime nga anëtarët e KPF-së u miratua:Shqyrtimi i shkresës së Projekt Buxhetit për vitin 2027-2029 si dhe i procedohet Asamblesë Komunale për shqyrtim dhe miratim.
Rezultati i votimit:7 për,0 kundër,0 abstenim.

Pika 3

Pika e tretë e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe trajtimi i kërkesave të pranuara në zyrën e Kryetarit.

Fatmir Ademaj(Kryesues i KPF-së):Zyrtari ligjor z.Muharremi ka punuar me Kryetarin në këtë fazë për trajtimin e kërkesave.Fjalën ja kalojë z.Muharrem Morinës.

Muharrem Morina(Zyrtar ligjor):Përshëndetje për të gjithë!Sot e pranove nga Valmiri Raportin e Auditimit të Pasqyrave Financiare vjetore të Komunës së Malishevës për vitin 2025-të i cili duhet me u prezantuar edhe në Kuvend sepse është obligim ligjor,ky është dokument voluminoz me të cilën ne sot nuk kemi arritur me fotokopjuar për të gjithë,mirëpo ky dokument është i publikuar në faqen zyrtare të komunës.A dëshironi me diskutuar më tutje?

Fatmir Ademaj(Kryesues i KPF-së):Atëherë meqenëse nuk diskutim e vendosim në votim.Kush është për?

Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa konstatoi se me vota unanime nga anëtarët e KPF-së u miratua:Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare vjetore të Komunës së Malishevës për vitin 2025-të si dhe i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.
Rezultati i votimit:7 për,0 kundër,0 abstenim.

Muharrem Morina(Zyrtar ligjor):E kemi një kërkesë prej drejtorit të drejtorisë së administratës,Raporti i Performancës të Komunës së Malishevës për vitin 2025-të,sipas vendimit të Kryetarit të komunës figuron që në vitin 2023 e ka themeluar një komision për raportim të menaxhimit të performancës komunale vendimin me numer rendor 01/08 viti 2023 ky është një komision i cili merret me punën dhe vlerësimin e performancës përpilohet një dokument pastaj dorëzohet në MAPL,ky është një komision i brendshëm,për fat ne nuk po mundemi me arritur mirë sepse edhe ju jeni duke e vërejtur në këtë tabel.Raporti i komunës së Malishevës në SMPK në nivel vendi ka 47% e cila rradhitet e 18 si komunë.Pra ne nuk jemi të kualifikuar për shkak të kontratave kolektive.Një ndër kriteret kryesore është vlerësimi i audimit dhe ky raport ka dalur keq për shkak të ndërhyrjeve të përmbaruesit,pra janë goditur planifikimet e shpenzimeve.

Fatmir Ademaj(Kryesues i KPF-së):Atëherë e vendosim për votim?Kush është për?
Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa konstatoi se me vota unanime nga anëtarët e KPF-së u miratua:Raporti i Performancës së Komunës së Malishevës për vitin 2025-të si dhe i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.
Rezultati i votimit:7 për,0 kundër,0 abstenim.

Muharrem Morina(Zyrtar ligjor):Ne e kemi edhe një propozim vendim nga Kryetari,ju e dini që dy herë jemi duke tenduar që me ndalur një projekt shumë të rëndësishëm për Komunën e Malishevës i cili i trajton dy kategorit më të ndjeshme të shoqërisë tonë,projekti "Jetimat e Ballkanit".Mjetet janë të gatshme por ata janë të zhgënjyer pse nuk janë duke pasur mundësi me inicuar një projekt të tillëi cili llogaritet prej tri milion e gjysmë deri në pesë milion për ndërtimin e një objekti për qëndrim ditor për të moshuarit,kuzhinën humanitare dhe fëmijët me nevoja të veqanta.Ne dy herë kemi marrë vendime mirëpo na kanë kthyer MAPL-ja sepse nuk është e rregulluar me ligj,ne kemi tendenc që këtë projekt me ndalur sepse prona është e komunës kurse shërbimet i kryen shoqata "Jetimat e Ballkanit" për të cilën ne kemi nevojë me pasur këtë projektë.

Veton Zogaj(anëtarë i KPF-së):Si kanë arritur komunat e tjera me realizuar këtë procedurë?

Muharrem Morina(Zyrtar ligjor):Për shembull në komunën e Graçanicës ju ka ndihmuar Qeveria ajo e ka shpronësuar pronën shtetërore sepse është e autorizuar me ligj dhe e ka bërë pronë shtetrore dhe pastaj përmes Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale sepse shërbimet që i ofronë kjo shoqat bënë pjesë në këtë ministri.Nëse deri në fund të vitit nuk arrijmë me bërë një marrëveshje me këtë shoqat atëherë këto mjetet duhet me i destinuar dikun tjetër.

Imran Xhylyqi(anëtarë i KPF-së):A është ky financim 100% i shoqatës "Jetimat e Ballkanit"?

Muharrem Morina(Zyrtar ligjor):Po, dhe ky është qëllimi që me ndalur këtë investim në Komunë.

Halil Morina(anëtarë i KPF-së):Secili prej neve jemi pro që me ndalur këtë projekt dhe neve na intereson me gjetur aspektin e duhur ligjor që me u kryer kjo procedurë dhe shpresoj që këtë herë e keni gjetur aspektin e duhur ligjor.

Muharrem Morina(Zyrtar ligjor):Komuna e Suharekës e ka zhvilluar përmes një kombinimi të ankandit publik dhe shprehjes së interesit sepse vlera e investimit është shumë e madhe.Pra e kemi kërkesën e Kryetarit të komunës për shyrtimin dhe miratimin e propozimit të vendimit , për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës së Malishevës në shfrytëzim afatshkurtër përmes ankandit publik, deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite, për organizatat e shoqërisë civile me qëllim të organizimit dhe funksionalizimin e "Qëndrimit ditor për të moshuar, kuzhinës humanitare dhe qendrës për fëmijë me nevoja të veçanta shëndetësore". Në kuadër të saj hynë edhe kërkesa për formimin e komisionit.

Fatmir Ademaj(Kryesues i KPF-së):Atëherë e vendosim për votim?Kush është për? Shqyrtimin dhe miratimin e propozimit të vendimit të kryetarit të komunës së Malishevës, për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës së Malishevës në shfrytëzim afatshkurtër përmes ankandit publik, deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite, për organizatat e shoqërisë civile me qëllim të organizimit dhe funksionalizimin e "Qëndrimit ditor për të moshuar, kuzhinës humanitare dhe qendrës për fëmijë me nevoja të veçanta shëndetësore".

Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa konstatoi se me vota unanime nga anëtarët e KPF-së u miratua: Propozim vendimit i kryetarit të komunës së Malishevës, për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës së Malishevës në shfrytëzim afatshkurtër përmes ankandit publik, deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite, për organizatat e shoqërisë civile me qëllim të organizimit dhe funksionalizimin e "Qëndrimit ditor për të moshuar, kuzhinës humanitare dhe qendrës për fëmijë me nevoja të veçanta shëndetësore" si dhe i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.
Rezultati i votimit:7 për,0 kundër,0 abstenim.

Muharrem Morina(Zyrtar ligjor):Ne e kemi kërkesën e Kryetarit të Komunës me të cilën e ka përcjellur shkresën e drejtorit të urbanizmit për inicimin e hartimit të planit zhvillimor komunal për vitin 2027-2039 dhe hartën zonale të komunës së Malishevës, ju e dini që vitin 2027 përfundon ai dokument që ka qenë dhe duhet me formuar një tjetër.

Fatmir Ademaj(Kryesues i KPF-së):Atëherë e vendosim për votim?Kush është për?
Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa konstatoi se me vota unanime nga anëtarët e KPF-së u miratua:Shqyrtimi i parashtresës së kryetarit të komunës nr.01/1599, dt.15.09.2026, në lidhje me kërkesën e drejtorisë për urbanizëm për inicimin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal 2027-2039 dhe Hartës Zonale të Komunës s Malishevës.
Rezultati i votimit:7 për,0 kundër,0 abstenim.

Muharrem Morina(Zyrtar ligjor):E kemi edhe një kërkesë,nga kompania "Edorrita" me seli në fshatin Mirush,ajo kompani ka kërkuar nga drejtoria e komunës me ja vazhduar afatin e kontratës për shfrytëzimin e pronës të cilën e ka fituar të drejtën e shfrytëzimit që nga viti 2005 por i përfundon në vitin 2035.Ata kanë investuar me miliona euro,për shkaqe të sigurisë juridike edhe financiare kompanitë të cilat bashkëpunojnë me të dhe dëshirojnë me investuar aty i kanë thënë që afati është shumë i shkurt dhe neve na duhet një siguri më e madhe juridike sepse afati është shumë i shkurtë i shfrytëzimit të pronës publike,dhe mbi këtë bazë e ka bërë një kërkesë ndaj Kuvendit komunal.Ligji e thotë kjartë që në momentin kur përfundon afati i kontratës së shfrytëzimit të pronës,Kryetari e themelon një komision i cili ka me shqyrtuar performancen e kompanisë qiranë që e ka paguar,mjetet që i ka investuar,pastaj përmbledhet një raport dhe këtë raport Kryetari jaù dorëzonë anëtarë të Asamblesë komunale me të cilën ata në bazë të votës vendosin që a me ja vazhduar më tutje afatin për dhënie në shfrytëzim.Në rastin konkrret ne kemi shkuar me analogji juridike e kemi zbatuar këtë dispozitë ligjore,Kryetari e ka formuar një komision,komisioni e ka bërë një raport si dhe ka konstatuar në bazë të ekspertizës gjygjësore të ekspertit se ai vërtetë e ka një sipërfaqe 16336 ari apo një hekter e 63 ari e 36 m është vërtetuar prej zyrtarit të gjeodetit që e ka caktuar gjykata.Unë personalisht nuk kam gjetur ndonjë dispozitë ligjore që e lejonë por në anën tjetër nuk kam gjetur ndonjë bazë ligjore që ja ndalonë.Nëse Kuvendi Komunal e konstaton që duhet me ja vazhduar për hir të biznesit,për hir të investimeve,për hir të sigurisë juridike të kompanisë,ju e vendosni se a me ja vazhduar afatin.Vendimi konkrret ka me shkuar në MAPL ata e konfirmojnë ligjshmërinë.

Halil Morina(anëtar i KPF-së):Unë e kam cekuar edhe më parë,që kërkesat të cilat janë drejtuar në zyrën e Kryetarit janë pika gjenerale,kontributi jonë në këtë pikë është zero sepse ne nuk e kemi materilain.Kërkesat e Kryetarit vijnë në momentin që ne jemi duke diskutuar,ato duhet me na ardhur së paku një ditë më parë që ne me ditur për qfarë jemi duke diskutuar.

Veton Zogaj(anëtar KPF-së):Unë pajtohem me atë që e tha Halili sepse janë disa pika që janë të ndjeshme sikur kjo tani që jemi duke e diskutuar,kur të shkonë pastaj në Kuvend një pjesë e madhe asambleistave nuk e kanë iden se për qfarë është duke u folur dhe ata vetëm e ngritin dorën atje,kjo është një pikë shumë e ndjeshme që me votuar sepse Muharremi tha që nuk ka gjetur asnjë bazë ligjore që e ndalonë afatin ligjor.Ne herën e fundit e kemi marrë një vendim për një investim tjetër që ka me u bërë aty sa e atakonë pastaj kjo?Ka pasur shumë opinion publik që ajo ka me u bërë,ajo zonë është lokalitet i njejtë,parku i Mirushës aty është ky biznes i cili operon,tani ka me shkuar edhe një biznes tjetër,tani ka aty shumë ndërlikime të cilat mund të paraqiten nuk është kaq e thjeshtë me u trajtuar në këtë seancë,kërkonë trajtim specifik.Ligji për dhënie në shfrytëzim të pronës publike është i kjartë,nëse për shembull mua më ka skaduar kontrata për biznis,komuna përsëri e shpallë në ankand publik atë zonë.

Muharrem Morina(Zyrtar ligjor):Unë jam duke e prezantuar kërkesën e palës është e drejtë e juaj se si e vendosni.

Halil Morina(anëtar i KPF-së):Unë jam duke ardhur këtu dhe jam i pa pregaditur sepse nuk e di se qfarë nënkuptonë kërkesa e palës.Të gjitha kërkesat teorikisht munden me u pregaditur më herët dhe me na sjellur neve që ne me i pasur sot përpara.

Fatmir Ademaj(Kryesues i KPF-së):Atëherë kush është për që kërkesa e kompanisë "Edorrita" të rekomandohet për Asamble komunale?
Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa konstatoi se me shumicë votash miratohet kërkesa e kompanisë "Edorrita" si dhe i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Rezultati i votimit:5 për,1 kundër,1 abstenim.

Muharrem Morina(Zyrtar ligjor):E kemi edhe një kërkesë të një qytetari i cili kërkon këmbimin e pronës private me pronën publike.
Fatmir Ademaj(Kryesues i KPF-së):Atëherë kush është për që kërkesa e palës me iniciale A.T për këmbimin e pronës private me pronë publike të rekomandohet për Kuvend?
Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa konstatoi se me shumicë votash miratohet kërkesa e palës me iniciale A.T për këmbimin e pronës private me pronë publike si dhe i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.
Rezultati i votimit:6 për,0 kundër,1abstenim.

Muharrem Morina(Zyrtar ligjor):Në mbledhjen e kaluar ne i kemi marrë disa vendime,por disa prej tyre duhet me u rishqyrtuar që nënkuptonë që duhet me i plotësuar edhe pak për me kaluar në MAPL,disa prej tyre duhet me i anuluar ne do ti sjellim të kopjuara të gjitha së bashku me rendin e ditës ju do ta lexoni arsyetimin pse duhet me u anuluar dhe pse duhet me u rishqyrtuar,e kemi përshembull kërkesën e palës në Banjë,pastaj e kemi kërkesën e "Ekoregjionit".

Halil Morina(anëtar i KPF-së):Vendimet të cilat i kthen MAPL-ja, a keni mundësi me na dërguar edhe neve që me parë arsyetimin se ku kemi bërë shkelje ligjore,sepse nganjëherë vendimet e MAPL-së jemi duke i marrë si bllanko.

Veton Zogaj(anëtar i KPF-së):Do të ishte mirë që ne me i parë ato vendime me arsyetim në mënyrë që mos me përsëritur të njejtin gabim.

Fatmir Ademaj(Kryesues i KPF-së):Vazhdojna me pikën e fundit të rendit të ditës.

Pika 4

Pika e katër e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe trajtimi i kërkesave të pranuara në zyrën e Kryesuesit.

Fatmir Ademaj(Kryesues i KPF-së):Ne i kemi pranuar disa kërkesa të qytetarëve,mirëpo gjashtë prej tyre janë vazhdimisht që kanë ardhur në zyre të cilët kanë pyetur a është trajtuar kërkesa e tyre dhe kanë pohuar se janë në gjendje të rëndë ekonomike,kërkojnë me i mbështetur dhe ne në këtë formë i kemi zgjedhur sot këto gjashtë kërkesa për me i trajtuar së bashku me juve,unë nuk i njoh asnjërin me tyre personalisht.Hapi diskutimin për këtë temë.

Veton Zogaj(anëtar i KPF-së):Në fillim të mbledhjes ishte prezent drejtori për ekonomi dhe financa Blerimi i cili tha që jemi zero me buxhet,unë nuk jam me marrë vendim sepse palët pastaj kanë me ardhur me kërkur ekzekutimin e mjeteve.Do të ishte mirë me pritur edhe pak pastaj me mbështetur kërkesat e qytetarëve.

Halil Morina(anëtar i KPF-së):Ne e kemi pasur një parim në mandatet e kaluara kërkesat e qytetarëve të cilat kanë qenë me sëmundje të rënda i kemi mbështetur,mirëpo ne sot e dim gjendjen financiare të buxhetit tonë dhe nuk është mirë me ju dhënë shpresa me marrë një vendim kurse mjetet mos me i dal kurrë.

Fatmir Ademaj(Kryesues i KPF-së):Unë kërkoj nga stafi që me njoftuar gjdo qytetarë që për momentin jemi në një fazë që nuk kemi mjete të mjaftueshme,derisa të rriten mjetet

financiare,pastaj ne do ti trajtojmë një numër të madh të kërkesave duke i mbështetur me mjete financiare.

Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa i përfundoi punimet e mbledhjes rreth orës:11:25

Malishevë,Shtator 2026 Procesëmbajtësja Kryesues i Kuvendit

Fatlume Delija Fatmir Ademaj